

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01- 14569

Dt.10.07.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vepruar sipas kërkesës së aplikuesit: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale -Komuna Gjakovë,për dhënjën e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e 6(gjashtë) objekteve të banimit individual-shtëpive familjare për rastet sociale, me etazhitet P+0, në bazë të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr.02/L-28 nenit 11, bien këtë:

A K T V E N D I M

- I. **I LEJOHET aplikuesit: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në Komunën e Gjakovës**, ndërtimi i 6 (gjashtë) objekteve të banimit individual-shtëpive familjare për rastet sociale sipas Projektit Kryesor të prezentuar për 2 tipe të shtëpive: Tipi 1. me dim. (12,30 x 6,70) m² (4 dhoma) dhe Tipi 2. me dim. (10,85 x 6,70) (3 dhoma), me etazhitet P +0, në ngastrën kadastrale ndërtimore nr.358-1 ZK Jahoc në pronësi P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjakovë, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në Planin e Situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objekteve në fjalë.

Tipi 1 = 2 shtëpi - me sip(bruto) të objektit S=82,41 m²

Tipi 2 = 4 shtëpi - me sip(bruto) të objektit S=72,69 m²

- II. Hartimin e projektit kryesor nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë studio projektuese N.N.P.I "ARCPROJECT" sh.p.k. Gjakovë.

- III. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilën është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo Drejtori i cili është bazë për ri;evimin gjeodezik të objekteve nga pika 1. e këtij aktvendimi.

- IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplarë origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është dhënë kjo Leje e Ndërtimit;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimin e punimeve nga pika 1. E këtij Aktvendimi, ta realizojë nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objekteve,
- Të lajmërojë Drejtorinë e Inspektionit për ditën e fillimit të punimeve së paku 8 (tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve;

- V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1 (një) vit nga dita e lëshimit të këtij Aktvendimi.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze 181 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390 322 -452, 320 070,325 059 Fax: +381 390 322 452

www.gjakova-komuna.org

Arsyetim

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në Komunën e Gjakovës, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01- 14569 datë 08.06.2017 për dhënjen e Lejës së Ndërtimit për ndërtimin e 6 (gjashtë) objekteve të banimit individual – shtëpive familjare për rastet sociale, me etazhitet P + 0, në ngastrën kadastrale ndërtimore nr. 358-1 ZK Jahoc në pronësi P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjakovë, siq është përshkruar në pikën 1. të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1: 500 të datës 03.07.2017 të vërtetuar nga DUMM
2. Kopjen e Planit të datës 08.06.2017 në pronësi të Kuvendit të Komunës Gjakovë të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë;
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e palujtshme me nr.2872-17 dt.08.06.2017 të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë;
4. Raporti për kërkimet gjeomekanike i përpiluar nga kompania "Geomerkur" Gjakovë
5. Vendimi i Kuvendit Komunal Gjakovë për ndarjen e parcelës për ndërtimin e shtëpive për raste sociale në Komunën e Gjakovës 01Nr.463/02-12765/2017 dt.15.05.2017
6. Maraveshje Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe Organizatës Joqeveritare "New Day Impact" nr.169 dt. 05.05.2017
7. Kërkesa e MPMS nr. 174 dt.15.04.2017
8. Lista e përfituesëve të 6 (gjashtë) familjeve
9. Pëlqimin nga KEDS me nr. 534/1 datë 04.04.2017
10. Pëlqimin nga KRU Radoniqi me nr.996 datë 05.04.2017
11. Projektin Kryesor në 2 (dy) kopje për të dy Tipet e shtëpive, të punuar nga studio projektuese N.N.P.I "ARCPROJECT" sh.p.k. Gjakovë.

Investitori është i liruar nga taksa administrative, në bazë të nenit 5, paragrafi 5.15, nënparagrafi b. të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesat Komunale, 01 Nr. 011-43964/2015 dt. 30.06.2015.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë dhe i njejta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit
- Drejtorisë së Inspekcionit
- Arkivës

pe **Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike**


Zenel Shabani, jur.dip.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh.dip.ark.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze 181 Gjakovë, Kosovë


Tel: +381 390 322 -452, 320 070, 325 059 Fax: +381 390 322 452

www.gjakova-komuna.org



01- 463/02-12765
19.05.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës – Gjakovë
01, nr. 463/02-12765 2017
Dt. 15.05.2017

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 10 pika 1.1. dhe 1.2 të Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, nenin 20 piks 3.1 dhe 3.2 të Rregullores së QKR-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e Jashtëzakonshme të mbajtur me datë 15.05.2017, pas diskutimit lidhur me pikën e 2-të, të rendit të ditës: Miratimi i Propozim Vendim për ndarjen e parcelës – pronës komunale për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale sipas obligimeve që dalin nga Ligji Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit , e miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e parcelës për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Komunën e Gjakovës

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin për ndarjen e parcelës në pronësi komunale për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Komunën e Gjakovës, sipas kërkesës nga Ministria për Punë dhe Mirëqenieje Sociale me nr. prot.174 të dt.15.04 2017
2. Parcela në pronësi të Komunës së Gjakovës e evidentuar me nr. 70705037-00358-1 Z.K Jahoc caktohet për ndërtimin e shtëpive për rastet sociale në Komunën e Gjakovës, sipas procedurave të përcaktuara në Ligjit nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit .
3. Parcela në pronësi të Komunës së Gjakovës e evidentuar me nr. 70705037-00358-1 Z.K Jahoc pas përfundimit të projektit për ndërtimin e shtëpive do të shfrytëzohet nga përfituesit në kohëzgjatje prej 99 viteve
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e komunës.


5. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetares së Komunës, znj. Mimoza Kusari-Lila
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Drejtoria Urbanizëm dhe Mbrojtje të mjedisit .
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
z. Luan Gola

PLAN SITUACIONI



Dimensionimi i trojeve